

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8338
E shtunë, 11 korrik 2026
Çmimi 0.50 €

“Bring them home”,
shfaqen grafite në
Prishtinë në mbështetje
të liderëve të UÇK-së



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



HAMZA PAS TAKIMIT ME KURTIN: PDK-JA MBETET NË OPOZITË



FACE 4-5

AKTUALE



**DJALI VIZITON JAKUP
KRASNOIN NË HAGË: ME BESIM
TË PALËKUNDUR NË TË VËRTETËN,
PRESIM EPILOGUN E PROCESIT** F. 3

**HAXHIU DEKORON ME MEDALJE
PRESIDENCIALE USHTARAKE
KOLONELIN AMERIKAN A. J. BERG** F. 5

**IKD-JA KËRKON NDRYSHIME PARA
MIRATIMIT TË LIGJIT PËR BYRONË
E KONFISKIMIT** F. 6

EKONOMI



**ASK-ja: INFLACIONI VJETOR NË
KOSOVË ARRIN NË 6 PËR QIND,
TRANSPORTI DHE ENERGJIA ME
RRITJEN MË TË MADHE** F. 8

**A KA KOSOVA RREGULLA TË QARTA
PËR PRODUKTET E QUMËSHITIT?** F. 8

SPORT



**“HISTORIA E MËRGIMIT DHE
RIVALITETI I NXEHTË ME
SERBINË”, MEDIUMI ARGJENTINAS
ME ARTIKULL TË VEÇANTË PËR
GRANIT XHAKËN** F. 11

Takimi i kryetarit të Vetëvendosjes, Albin Kurti, dhe atij të PDK-së, Bedri Hamza, përfundoi pa ndonjë rezultat konkret lidhur me formimin e institucioneve të reja. Kurti ka

thënë se, si udhëheqës i partisë fituese të zgjedhjeve, përgjegjësia e tij është formimi i qeverisë, por ka përsëritur qëndrimin se, për çështjen e presidentit, përgjegjësia u

takon të gjithëve. Ndërsa Hamza ka konfirmuar se partia e tij do të mbetet në opozitë, duke shtuar se IV-ja e ka përgjegjësinë për formimin e institucioneve

**HODGES: NGËRÇI
POLITIK E BËN
KOSOVËN MË TË
CENUESHME
NDAJ NDIKIMEVE
TË JASHTME** F. 3



**RAMA:
S'LEJOJMË QË
ANËTARËSIMI NË
BE TË BANALIZOHET,
INTEGRIMI PREK
JETËN E ÇDO
SHQIPTARI** F. 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Peshko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TË PAKTËN 11 TË VDEKUR DHE 19 TË ZHDUKUR PAS ZJARREVE NË SPANJË

MADRID, 10 KORRIK - Të paktën 11 persona kanë humbur jetën dhe 19 të tjerë konsiderohen të zhdukur pas zjarreve në jug të Spanjës, ka bërë të ditur kreu i qeverisë rajonale të Andaluzisë, Juan Manuel Moreno Bonilla. "Aktualisht janë të paktën 19 persona që konsiderohen të zhdukur dhe 11 persona që janë konfirmuar të vdekur, të cilët po udhëtonin me të njëjtën makinë", ka deklaruar ai për radion "Cope", duke shtuar se "mund të kemi edhe viktimën e dymbëdhjetë".

Zjarret e mëdha kanë përfshirë një zonë në jug të Spanjës, ku humbën jetën 11 persona. Sipas autoriteteve, në mesin e viktimave mund të jenë edhe katër shtetas britanikë, të cilët u

dogjën teksa po udhëtonin me makinë, ndërsa temperaturat e larta kanë përfshirë pjesën më të madhe të Evropës jugore.

Rreth 400 zjarrfikës dhe pjesëtarë të ekipeve të emergjencave po luftojnë me flakët në verilindje të Almerisë, në rajonin e Andaluzisë. Dëshmitarët kanë thënë se zjarri mund të ketë nisur pasi kablo elektrike janë rrëzuar në tokë.

Të premtën, temperaturat në Spanjë dhe Francë kanë arritur deri në 40 gradë celsius, ndërsa të dyja vendet po përballeshin me zjarre pyjore.

Ministri rajonal i emergjencave në Andaluzi, Antonio Sanz, ka bërë me dije se tetë persona janë lënduar, katër prej të cilëve ndodhen në gjendje të rëndë.



Sipas tij, rreth 3.150 hektarë tokë janë shkruar.

Ndërsa kryeministri spanjoll, Pedro Sanchez, ka shkruar në platformën "X" se është "thellësisht i pikëlluar nga pasojat e tmerrshme të zjarreve".

Ai ka bërë me dije se Spanja do të angazhojë ekipin më të madh të saj të dërguar ndonjëherë për përballeshimin e zjarreve gjatë verës.

Zjarret kanë shpërthyer në një kohë kur Spanja po përballesh me

një valë të të nxehtit. Vitet e fundit, ky shtet ka regjistruar shpesh temperatura mbi 40 gradë celsius, duke krijuar kushte të favorshme për përhapjen e zjarreve.

Vitin e kaluar, Spanja kishte regjistruar vitin e tretë më të nxehtë në histori. Më herët gjatë këtij muaji, qindra zjarrfikës u angazhuan për shuarjen e zjarreve pranë brigjeve të Kosta Bravës. Edhe vitin e kaluar, Spanja ishte përballesh me zjarre të mëdha, ku ishin djegur rreth 400 mijë hektarë tokë.

Ndërkohë, ditët e fundit edhe Franca po përballesh me zjarre. Një vatër zjarri në rajonin Dromë, në juglindje të vendit, ka shkruar rreth 3 700 hektarë tokë brenda dhjetë ditësh.

NGUSHTICA E HORMUZIT MBETET E PAQËNDRUESHME, ANIJET KALOJNË ME MASA TË SHTUARA SIGURIE

TEHERAN, 10 KORRIK - Trafiku detar në ngushticën e Hormuzit ka vazhduar edhe gjatë ditës së djeshme, megjithëse ekspertët paralajmërojnë se situata mbetet e paqëndrueshme për shkak të tensioneve të vazhdueshme në rajon.

Bridget Diakun, analiste në "Lloyd's List Intelligence", ka deklaruar se disa anije kanë ndalur transmetimin e sinjalit të vendndodhjes gjatë kalimit në këtë rrugë ujore strategjike, një praktikë e njohur si "lundrim në errësirë", e cila përdoret për arsye sigurie.



Sipas të dhënave paraprake të "Lloyd's List Intelligence", gjatë muajit të kaluar janë regjistruar të paktën 576 kalime anijesh në

Ngushticën e Hormuzit, një rritje krahasuar me 233 kalime në muajin maj. Megjithatë, kjo shifër mbetet dukshëm më e

ulët se 3.131 kalimet e regjistruara në qershor të vitit të kaluar.

Ndërkohë, Operacionet e Tregtisë Detare të Mbretërisë së Bashkuar (UKMTO) kanë njoftuar se trafiku detar po vijon në nivele të reduktuara, duke përdorur si korridorin jugor pranë Omanit, ashtu edhe rrugën veriore nën kontrollin e Iranit.

Sipas UKMTO-së, niveli aktual i lëvizjes së anijeve tregon një qasje të kujdesshme nga kompanitë detare, ndërsa kalimet e asistuara nga Shtetet e Bashkuara kanë vazhduar pa

ndërprerje edhe gjatë kësaj jave. Autoritetet britanike kanë paralajmëruar gjithashtu për rrezikun nga minat detare të paidentifikuara ose të zhvendosura nga pozicionet e tyre, të cilat mund të përbëjnë kërcënim për sigurinë e lundrimit.

Nga ana tjetër, Marina e Gardës Revolucionare Islamike të Iranit (IRGC) ka deklaruar se veprimet e ShBA-së në ngushticën e Hormuzit do të "pengojnë seriozisht" rihapjen e plotë të saj, në një kohë kur trafiku detar kishte nisur të rikuperohej pjesërisht gjatë javëve të fundit.

ITALIA KRYESON TURIZMIN EVROPIAN NË VERËN E VITIT 2026

Romë, 10 korrik - Italia po konfirmon edhe një herë statusin e saj si një nga destinacionet turistike më të preferuara në botë. Për sezonin veror të vitit 2026, vendi renditet ndër zgjedhjet kryesore të turistëve evropianë dhe ndërkombëtarë, ndërsa operatorët e sektorit parashikojnë një nga sezonet më të suksesshme të viteve të fundit. Sipas të dhënave nga industria e turizmit, rezervimet janë në nivele shumë të larta, me kërkesë të shtuar për destinacione

ikonike si Roma, Venecia, Firenze, Napoli, Bregu i Amalfit, Siçilia dhe Sardenja. Vizitorët vazhdojnë të tërhiqen nga kombinimi unik i historisë, artit, plazheve, gastronomisë dhe peizazheve që Italia ofron në çdo rajon të saj.

Përveç trashëgimisë së pasur kulturore dhe kuzhinës së njohur në mbarë botën, suksesi i këtij sezoni lidhet edhe me investimet në infrastrukturën turistike, zgjerimin e lidhjeve ajrore ndërkombëtare dhe organizimin



e një kalendari të pasur me festivale, koncerte, ekspozita dhe ngjarje kulturore gjatë gjithë verës.

Megjithatë, fluksi rekord i turistëve sjell edhe sfida të rëndësishme. Autoritetet italiane

po punojnë për menaxhimin e turizmit masiv në qytetet dhe destinacionet më të vizituara, duke zbatuar masa për mbrojtjen e monumenteve historike, rregullimin e fluksit të vizitorëve dhe promovimin e zonave më pak të njohura, me synim shpërndarjen më të mirë të turizmit në të gjithë territorin. Ekspertët vlerësojnë se këto politika do të ndihmojnë në ruajtjen e ekuilibrit mes zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së trashëgimisë

kulturore e natyrore, duke garantuar një model më të qëndrueshëm turizmi në vitet e ardhshme.

Me kombinimin e historisë mijëra vjeçare, qyteteve ikonike, peizazheve mahnitëse dhe stilit të jetesës mesdhetare, Italia vazhdon të mbetet një nga destinacionet më të dëshiruara në Evropë, duke u përgatitur për një verë rekord si për numrin e vizitorëve, ashtu edhe për ndikimin ekonomik që pritet të sjellë për vendin.

Irani varros Ajatollah Ali Khamenein në një faltore

MASHHAD, 10 KORRIK - Udhëheqësi i ndjerë suprem i Iranit, Ajatollah Ali Khamenei, është varrosur në orët e para të mëngjesit të së premtes, sipas kohës lokale.

Varrimi është bërë në faltoren e Imam Rezas në qytetin e Mashhadit, ku kishte lindur Khamenei. Në ceremoninë private morën pjesë familjarët e tij, pas një

ceremonie mortore publike disa ditore, gjatë së cilës mijëra qytetarë i dhanë lamtumirën e fundit. Udhëheqësi i ri suprem, Mojtaba Khamenei, nuk

është parë në publik gjatë ceremonive mortore. Khamenei ishte varur në një sulm ajror i ShBA-së dhe Izraelit në muajin shkurt të këtij viti.



“BRING THEM HOME”, SHFAQEN GRAFITE NË PRISHTINË NË MBËSHTETJE TË LIDERËVE TË UÇK-së

PRISHTINË, 10 KORRIK - Në Prishtinë janë shfaqur grafitet me mesazhe mbështetëse për ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), të cilët ndodhen në paraburgim në Hagë. Grafitet me moton “Bring them home” (Ktheni në

shtëpi) duket se shprehin kërkesën për kthimin në Kosovë të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Aktgjykimi ndaj katër ish-udhëheqësve të UÇK-së pritet të shpallet më 16 shtator, në

orën 10:00, pas shtyrjeve të mëparshme të datës së vendimit. Deri në atë kohë, Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi do të kenë kaluar 2 141 ditë në paraburgim në Hagë, në pritje të epilogut të procesit gjyqësor.



HAGA ARSYETOHET PËR MBAJTJEN NË PARABURGIM TË THAÇIT, VESELIT, KRASNIQIT E SELIMIT



HAGË, 10 KORRIK - Më 1 korrik Gjykata Speciale në Hagë kishte njoftuar se është shtyrë data për marrjen e vendimit dhe shpalljen e aktgjykimit ndaj liderëve të të UÇK-së në Hagë. Ndërsa të premtën, zëdhënësi i Gjykatës Speiale, Michael Doyle ka folur për mbajtjen në paraburgim të katërshes së UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Ai ka thënë se gjyqtarët për

çdo dy muaj kanë bërë vlerësimet e tyre rreth asaj nëse ka nevojë për mbajtje në paraburgim. Doyle ka thënë se fakti që asnjëri s'është liruar ka të bëjë me rrezikun që ata të kryejnë vepra penale të tjera, sidomos ndaj atyre që kanë dëshmuar në proces ndaj tyre. “Çdo dy muaj, trupi gjyqësor në çështjen Thaçi etj. shqyrton nëse paraburgimi është ende i nevojshëm dhe proporcional për të pandehurit gjatë

gjyqimit të tyre. Deri më tani, ata gjithmonë kanë arritur në përfundimin se ekziston rreziku që z. Thaçi dhe të bashkëpandehurit e tij të kryejnë vepra të mëtejshme penale, veçanërisht kundër personave që dëshmuar në gjykimin e tyre”, ka deklaruar Doyle. Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020.

DJALI VIZITON JAKUP KRASNIQIN NË HAGË: ME BESIM TË PALËKUNDUR NË TË VËRTETËN, PRESIM EPILOGUN E PROCESIT

Hagë, 10 korrik - Deputeti i zgjedhur i PDK-së, Altin Krasniqi, djali i Jakup Krasniqit, e ka vizituar të premtën babanë e tij në Hagë. Kjo vizitë vjen në një kohë kur kanë mbetur edhe pak javë deri te aktgjykimi për katër ish-udhëheqës të UÇK-së. “Sot isha për vizitë në Hagë. Kanë mbetur edhe pak javë deri te vendimi përfundimtar. Pavarësisht gati gjashtë vjetëve të padrejtësisë, një gjë ka mbetur e pandryshuar: krenaria për luftën çlirimtare, për idealin e lirisë dhe për ata që nuk u përkulën as atëherë e as sot. Me besim të palëkundur



në të vërtetën dhe me kokën lart, presim epilogun e këtij

proces”, ka shkruar ai në “Facebook”.

Gjykata Speciale në Hagë ka njoftuar më 1 korrik se aktgjykimi për katër ish-udhëheqës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin, do të shpallet më 16 shtator të këtij viti. Në një njoftim për medie, gjykata ka bërë të ditur se trupi gjyqësor ka caktuar datën e shqiptimit të aktgjykimit për 16 shtator 2026, në orën 10:00. “Trupi gjyqësor shpjegoi se koha e nevojshme për kuvendimet ishte zgjatur në përputhje me Rregulloren, për shkak të vëllimit të madh të

provave të marra dhe kompleksitetit të procesit gjyqësor, dhe se kjo zgjatje përligjet nga nevoja për të bërë një vlerësim të arsyetuar, tërësor dhe të drejtë të dokumentacionit të çështjes”, ishte thënë në njoftimin e Speciales. Katërshja e UÇK-së gjendet në qendrën e paraburgimit në Hagë që nga nëntori i vitit 2020. Procesi gjyqësor ndaj tyre ka nisur në prill të vitit 2023. Që nga dita e parë e këtij procesi, ata janë deklaruar të pafajshëm për akuzat me të cilat ngarkohen nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.

Rama: S'lejojmë që anëtarësimi në BE të banalizohet, integrimi prek jetën e çdo shqiptari

TIRANË, 10 KORRIK - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka deklaruar se procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian nuk duhet të shihet si një çështje e largët politike, por si një proces që ndikon drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve dhe ekonominë e vendit. Gjatë fjalës së tij në eventin “Rilindja 2.0”, Rama është shprehur se përfitimet nga integrimi evropian duhet të bëhen të prekshme për qytetarët dhe bizneset.

“Nuk mund të lejojmë që çështja e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian të banalizohet dhe që njerëzit ta ndjejnë si një çështje që nuk lidhet me jetën e tyre të përditshme, sepse është tërësisht e pavërtetë”, ka deklaruar Rama. Sipas tij, afrimi me BE-në do të ketë ndikim të drejtpërdrejt në ekonominë e shqiptarëve, veçanërisht për brezin e ri. “Ky është një proces historik për një arsye, por është

gjithashtu një proces historik për ekonominë e kujtdo. Është ekonomia e atyre që sot janë të rinj dhe të reja që do të përfitojë më shumë nga ky proces”, ka thënë kryeministri Rama. Gjatë fjalës së tij, Rama ka folur edhe për disa programe të reja qeveritare, përfshirë mbështetjen për bizneset përmes garancisë sovrane, e cila, sipas tij, do t'i ndihmojë kompanitë të rrisin kapacitetet dhe të kenë qasje më të madhe në financim.





HAMZA PAS TAKIMIT ME KURTIN: PDK-ja MBETET NË OPOZITË

Takimi i kryetarit të Vetëvendosjes, Albin Kurti, dhe atij të PDK-së, Bedri Hamza, përfundoi pa ndonjë rezultat konkret lidhur me formimin e institucioneve të reja. Kurti ka thënë se, si udhëheqës i partisë fituese të zgjedhjeve, përgjegjësia e tij është formimi i qeverisë, por ka përsëritur qëndrimin se, për çështjen e presidentit, përgjegjësia u takon të gjithëve. Ndërsa Hamza ka konfirmuar se partia e tij do të mbetet në opozitë, duke shtuar se LV-ja e ka përgjegjësinë për formimin e institucioneve

konsensuale për postin e presidentit, duke theksuar se një kandidaturë e tillë do të ishte në përputhje me Kushtetutën. “Në pikënisje do ta kishim një figurë konsensuale. Pra, dikush që nuk është i asnjë partie politike, dikush që është përtej polemikave të skenës aktuale, dikush që ka vlera të dëshmuara kombëtare, profesionale e qytetare dhe, në këtë mënyrë, të jetë shprehje e unitetit, ashtu siç e kërkon kushtetutshmëria jonë. Kjo nuk është vetëm ideja dhe kërkesa jonë, por është fryma dhe germa e Kushtetutës”, ka thënë Kurti. Sipas tij, LV-ja, PDK-ja dhe LDK-ja së bashku kanë numrin e mjaftueshëm për t’i konstituuar të gjitha institucionet. Kurti ka vlerësuar se, me 53 mandatet e LV-së dhe ato të partive të komuniteteve pakicë joserbe, ai i ka mbi 61 votat e nevojshme për qeverinë, por nuk ka treguar nëse menjëherë pas konstituimit të Kuvendit do të procedohet me votimin e ekzekutivit të ri. “Ne jemi të interesuar që t’u japim kohë diskutimeve dhe konsultimeve, në mënyrë që legjislatura të ketë jo vetëm kryetar dhe qeveri, por edhe president”, ka thënë Kurti.

Hamza: PDK-ja do të jetë në opozitë

Ndërsa kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, ka konfirmuar se partia e tij do të mbetet në opozitë në mandatin e ri qeverisës. “Bazuar në bisedat dhe diskutimet që kemi pasur, normalisht korrekte, qëndrimi ynë është se PDK-ja, për këtë mandat, është parti në opozitë dhe ne i dëshirojmë sukses zotit Kurti dhe të gjithë atyre që takohen e bisedojnë për t’i dhënë vendit institucione, duke i përfshirë të gjitha institucionet”, ka thënë Hamza në një deklaratë për medie pas takimit me Kurtin. Hamza ka thënë se përgjegjësia për formimin e institucioneve i takon LV-së, duke theksuar se të gjitha partitë e tjera nuk mund ta zgjedhin kreun e ri të shtetit pa partinë e Kurtit. “LV-ja duhet të gjejë partnerë, sipas nevojave dhe kriterëve të saj, si dhe interesave të tyre, për t’i dhënë vendit institucione”, ka thënë Hamza. Takimet mes udhëheqësve politikë vijnë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, të cilat janë mbajtur pasi, muaj më parë, partitë kishin dështuar të arrinin konsensus për presidentin e ri të vendit. Kurti e ka ftuar në takim edhe kreun e Aleancës, Ardian Gjini,

por ai e ka refuzuar ftesën, duke argumentuar se partia e tij tashmë i ka paraqitur gjashtë kushte që do të duhej t’i plotësonte Kurti në këmbim të mbështetjes për krijimin e institucioneve.

Sipas rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të 7 qershorit, LV-ja e Kurtit ka fituar 53 mandate, PDK-ja 22 ulëse, LDK-ja 18 dhe Aleanca shtatë. Pas certifikimit të rezultateve, deputetët e legjislaturës së re kanë përpara detyrën e konstituimit të Kuvendit, formimin e qeverisë dhe zgjedhjen e presidentit.

Për dy të parat kërkohen 61 vota në Kuvendin me 120 ulëse. Partia e Kurtit i ka votat për dy proceset e para, pasi llogarit në votat e partive të pakicave joserbe, që kanë dhjetë mandate.

Megjithatë, ende nuk ekziston një marrëveshje apo konsensus rreth emrit të presidentit. Për zgjedhjen e presidentit nevojitet prania e dy të tretave të deputetëve në Kuvend, në mënyrë që votimi në dy raundet e para të jetë i vlefshëm. Në mungesë të një marrëveshjeje politike, kjo është e pamundur për secilën parti parlamentare. Fituesja e zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje, ka thënë se çdo diskutim për formimin e qeverisë do të bëhet pasi të ketë një pasqyrë të plotë të përbërjes së Kuvendit të Kosovës.

**EPOKA
ERE** **Lirim GECI**

PRISHTINË, 10 KORRIK – Kryeministri në detyrë dhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, është takuar të premten me kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, dhe atë të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ku kanë diskutuar për formimin e institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 7 qershor.

Pas takimit me Hamzën, Kurti ka thënë se takimi ishte konstruktiv, por nuk ka prodhuar ndonjë rezultat konkret për formimin e institucioneve të reja. “Me kryetarin e PDK-së, Bedri

Hamza, u takuam së pari në këtë raund të katër takimeve. Unë e falënderoj kryetarin Hamza për këtë takim, i cili ishte takim i parë dhe konstruktiv, që kaloi në atmosferë vullneti dhe interesimi për t’i dhënë institucione të reja Kosovës, në përputhje me vullnetin e popullit. Aktualisht nuk mund të themi se kemi një rezultat konkret, ndonjë të arritur që ta ndajmë me popullin”, ka thënë Kurti. Ai ka thënë se, si udhëheqës i partisë fituese të zgjedhjeve të qershorit, përgjegjësia e tij është formimi i qeverisë, por ka përsëritur qëndrimin se, për çështjen e presidentit, përgjegjësia është e të gjitha partive. Po ashtu, Kurti ka përsëritur qëndrimin për një figurë

Rama prezanton projektin e lidhjes së "Rrugës A" me lagjen "Emshir"

PRISHTINË, 10 KORRIK - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar se është finalizuar projekti i penetrimit të Veternikut. Sipas Ramës, me këtë

investim do të krijohet një lidhje e re ndërmjet Rrugës A dhe lagjes Emshir, duke lehtësuar ndjeshëm qarkullimin dhe duke shkarkuar trafikun në hyrje të

Prishtinës. "Projekti i penetrimit të Veternikut është finalizuar. Me këtë investim krijojmë një lidhje të re ndërmjet Rrugës A dhe lagjes Emshir, duke lehtësuar

ndjeshëm qarkullimin dhe duke shkarkuar trafikun në hyrje të Prishtinës, veçanërisht për automjetet që vijnë nga Gjilani, Ferizaj dhe autostrada", ka njoftuar Rama.



AMERIKA UA GJETI EDHE DHEUN NËN KËMBË: SULMI NË IBËR-LEPENC VEPËR E SHTETIT SERB, PROKURORIA SPECIALE ME PROVA TË FORTA

PRISHTINË, 10 KORRIK - Sulmi ndaj kanalit Ibër-Lepenc kishte për qëllim dëmtimin e rëndë të funksionalitetit të vendit. Tre nga të dyshuarit për këtë sulm tashmë kanë nisur përballjen me drejtësinë. Sipas Prokurorisë Speciale të Kosovës, ata, në koordinim me strukturat e shtetit serb, kishin synuar kanalën e Ibër-Lepencit, ku kishin vendosur dhe shpërthyer 20 kilogramë eksplozivë.

Prokuroria Speciale ka thënë se posedon prova të forta për këtë rast.

Të përballur me një numër të madh provash, nga mostrat e dheut të siguruar nga Byroja Federale e Hetimeve (FBI) në vendin e ngjarjes, te fitili i përdorur, armët, uniformat ushtarake dhe trajnimet në poligonin ushtarak serb të njohur si "Livadhet e Pasulit", dy vëllezërit serbë Dragisha dhe Jovan Viqentijeviq, si dhe Igor Dimiq, janë deklaruar të pafajshëm.

Prokuroria Speciale ka konstatuar se sulmi terrorist ndaj kanalit Ibër-Lepenc, më 29



nëntor 2024, ishte një operacion i planifikuar dhe i koordinuar, e jo një veprim spontan. Sipas prokurorisë, sulmi ishte pjesë e një serie veprimesh kundër rendit juridik dhe sigurisë kombëtare të Kosovës, pas sulmit ndaj KQZ-së në Mitrovicë në vitin 2022, sulmit ndaj KFOR-it, barrikadave dhe sulmit të armatosur në Banjskë në vitin 2023.

Prokuroria ka pretenduar se të akuzuarit kishin vendosur 20 kilogramë eksploziv "TNT" me qëllim dëmtimin e

infrastrukturës kritike të furnizimit me ujë dhe sistemit energjetik të Kosovës.

Aktakuza mbështetet në prova të mbledhura nga Policia e Kosovës, Agjencia e Forenzikës, analizat e ADN-së, ekspertizat e FBI-së, policisë italiane, KFOR-it amerikan, si dhe analizat e pajisjeve elektronike.

Gjatë kontrolleve, sipas prokurorisë, janë sekuestruar armë, municion, granata, uniforma dhe pajisje ushtarake, duke çuar edhe në ngritjen e akuzave për armëmbajtje pa

leje. Për Jovan Viqentijeviqin, prokuroria pretendon se ka vepruar në interes të shërbimit inteligjent ushtarak serb, duke mbledhur dhe transmetuar informacione konfidenciale, për çka akuzohet edhe për spiunazh.

Prokuroria gjithashtu pretendon se një pjesë e përgatitjeve dhe trajnimeve janë zhvilluar në Serbi, në poligonin ushtarak "Livadhet e Pasulit", dhe se institucionet serbe kanë pasur rol në organizimin e tyre. Përfaqësuesit e Ibër-Lepencit e kanë mbështetur aktakuzën, duke theksuar dëmet materiale dhe rrezikun për një krizë energjetike dhe sanitare. Prokuroria mbështet një pjesë të rëndësishme të aktakuzës në prova shkencore, veçanërisht në ekspertizat e FBI-së dhe analizat e ADN-së, të cilat, sipas saj, i lidhin të akuzuarit me vendin e sulmit.

Sipas raportit të FBI-së, analizat gjeologjike kanë treguar se dheu i gjetur në çizmet e Jovan dhe Dragisha Viqentijeviqit përputhet me mostrat e marra

në vendin e shpërthimit të kanalit e Ibër-Lepencit.

Aktakuza ka theksuar se nuk është konstatuar dallim në strukturë, ngjyrë dhe përbërje të mostrave, duke e paraqitur këtë si një nga provat kryesore që i lidh të akuzuarit me vendngjarjen. Një tjetër provë e rëndësishme është ekspertiza e ADN-së, e realizuar nga Agjencia e Forenzikës së Kosovës dhe e verifikuar nga Policia Shkencore e Italisë. Sipas prokurorisë, ADN-ja e Jovan Viqentijeviqit është identifikuar në një fitil ndezës 9.2 metra të gjatë, të gjetur pas sulmit. Nga 24 lokuse të analizuar, 20 prej tyre përputheshin me profilin gjenetik të tij, çka, sipas ekspertëve, ofron "mbështetje jashtëzakonisht të fortë statistikore" për kontaktin e drejtpërdrejtë me fitilin ndezës. Prokuroria pretendon se këto prova shkencore mbështesin akuzën se sulmi ishte një operacion i planifikuar ndaj infrastrukturës kritike të Kosovës dhe jo një akt i izoluar.

GJYKATA RIHAP GJYKIMIN PËR VRASJEN E TREFISHTË NË GLLOGJAN

PEJË, 10 KORRIK - Gjykata Themelore në Pejë ka vendosur ta rihapë gjykimin ndaj Halil Kastriot dhe Kreshnik Mehmetaj, të akuzuar për vrasjen e trefishtë në Gllogjan, ngjarje e ndodhur në nëntor të vitit 2021.

Vendimi është marrë në seancën ku ishte paraparë shpallja e aktgjykimit për këtë rast. Sipas aktakuzës së prokurorisë, të akuzuarit dyshohet se e kanë kryer sulmin në bashkëpunim dhe me motive hakmarrjeje. Organi i akuzës pretendon se cak i sulmit ishte shoferi i autobusit, i ndjeri Gani Gjokaj, të

cilin familja Mehmetaj e kishte fajësuar si përgjegjës për vetëvrasjen e vajzës së tyre, Heroina Mehmetaj.

Në aktakuzë është thënë se Halil Mehmetaj ishte betuar për hakmarrje ndaj Gjokajt dhe se gjatë ceremonisë së varrimit të vajzës së tij, kishte vendosur orën e dorës në arkivolin e saj. Sipas prokurorisë, të akuzuarit kishin studiuar me kujdes vendin e ngjarjes, duke u siguruar për mungesën e kamerave të sigurisë dhe të shtëpive në afërsi, para se t'i zinin pritë autobusit që qarkullonte në linjën Gjakovë-Gllogjan.



Aktakuza pretendon se Kastriot Mehmetaj, i armatosur me një pushkë automatike "AK-47", kishte dalë në mes të rrugës duke u shtirur si person i dehur, me qëllim që ta detyronte shoferin të ngadalësonte ose të ndalonte autobusin.

Sipas aktakuzës, pasi shoferi fillimisht e kishte sinjalizuar me

drita dhe më pas kishte ulur shpejtësinë, Kastriot Mehmetaj, nga një distancë prej rreth gjashtë metrash, kishte qëlluar me armë zjarri në drejtim të shoferit Gani Gjokaj, duke e lënë të vdekur atë, si dhe dy nxënësit 17-vjeçarë, L.H. dhe G.M., ndërsa F.T. kishte mbetur i plagosur rëndë.

Prokuroria është duke pretenduar se pas kryerjes së veprës, Kastriot Mehmetaj ishte larguar nga vendi i ngjarjes drejt fshatit Shaptej, ku e priste me veturë Kreshnik Mehmetaj. Sipas aktakuzës, pas mbërritjes në shtëpi, arma e përdorur në krim

ishte shkatërruar.

Po ashtu, sipas organit të akuzës, Halil Mehmetaj, gjatë periudhës nga 14 qershori 2020 deri më 26 nëntor 2021, dyshohet se i kishte nxitur Kastriotin dhe Kreshnikun për vrasjen e Gani Gjokajt, duke e konsideruar atë përgjegjës për vetëvrasjen e vajzës së tij.

Në seancën e së premtes ishin të pranishëm edhe familjarët e viktimave, të cilët hynë në sallën e gjykitimit ku pritej shpallja e aktgjykimit. Megjithatë, gjykata ka vendosur rihapjen e procesit gjyqësor, duke shtyrë shpalljen e vendimit.

MPB-ja publikon raportin statistikor për qershorin 2026: U lëshuan 872 lejeqëndrime të përkohshme dhe 12 të përhershme

PRISHTINË, 10 KORRIK - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka publikuar raportin statistikor për muajin qershor 2026, ku paraqiten të dhënat për shtetësinë, migracionin, azilin dhe lejeqëndrimet në Kosovë.

Sipas raportit të MPB-së, gjatë këtij muaji janë lëshuar gjithsej

872 lejeqëndrime të përkohshme, ndërsa janë dhënë edhe 12 lejeqëndrime të përhershme.

Në fushën e shtetësisë, MPB-ja ka bërë me dije se janë marrë 100 vendime për lirim nga shtetësia, ndërsa për fitimin e shtetësisë janë regjistruar 292

vendime pozitive dhe 257 vendime negative.

Për rifitimin e shtetësisë janë dhënë 556 vendime pozitive dhe 9 vendime negative.

Sa i përket emigracionit dhe mbrojtjes ndërkombëtare, në Qendrën e Përkohshme të Pritjes për Migrantë gjatë muajit

qershor janë akomoduar 72 migrantë, ndërsa në Qendrën e Azilit janë regjistruar 8 aplikime.

Në Qendrën e Mbajtjes për të Huaj nuk është regjistruar asnjë person i ndaluar. Raporti i publikuar nga MPB-ja përfshin të dhënat mujore të Departamentit për Natyralizim,



Azil dhe Migracion dhe pasqyron aktivitetet e institucioneve në këto fusha gjatë muajit qershor.

IKD-ja KËRKON NDRYSHIME PARA MIRATIMIT TË LIGJIT PËR BYRONË E KONFISKIMIT

PRISHTINË, 10 KORRIK - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka vlerësuar se draftligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme ka shënuar përparim krahasuar me versionet e mëparshme, por ende përmban mangësi që duhet të adresohen para miratimit të tij.

Gjatë prezantimit të raportit "Pasuria e pajustificueshme, drejtësia e justifikueshme", hulumtuesi i lartë i IKD-së, Gëzim Shala, ka deklaruar se projektligji është diskutuar për gjashtë vjet dhe është rrezuar dy herë nga Gjykata Kushtetuese.

Ai ka theksuar se, ndonëse janë reflektuar disa nga gjetjet e Gjykatës Kushtetuese, ende mbeten çështje serioze që kërkojnë rishikim. "Gjetjet tregojnë se ende mbetin çështje të hapura në raport me këtë projektligj. Përkundër faktit se qëllimi mund të jetë legjitim, është po ashtu legjitime që ky projektligj të

garantojë siguri juridike dhe mbrojtje nga arbitrariteti, në mënyrë që të jetë një mjet i sundimit të ligjit në fushën e luftimit të pasurisë së pajustificueshme dhe, në asnjë rrethanë, një mjet arbitrar ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij ligji.

Fillimisht, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka vlerësuar përparimin e bërë në këtë draft krahasuar me draftin paraprak, në kuptim të përfshirjes së gjetjeve të Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, ende mbetin çështje serioze të hapura, të cilat kërkojnë rishikim të këtij projektligji para miratimit të tij. Byroja do të ketë një mandat të rëndësishëm dhe, për këtë arsye, edhe procedura dhe mandati i saj duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të mos krijojnë hapësirë për arbitraritetin", është shprehur Shala.

Më tutje, Shala ka deklaruar se draftligji duhet të garantojë pavarësi më të madhe të Byrosë, duke rekomanduar që



drejtori dhe anëtarët e komisionit mbikëqyrës të zgjidhen me të paktën 61 vota në Kuvend.

Ai ka ngritur shqetësime edhe për paqartësitë në përcaktimin e termit "pasuria në masën më të lartë", si dhe për mungesën e një divizioni të specializuar në Gjykatën e Apelit për trajtimin e këtyre rasteve. "Një prej çështjeve kryesore që lidhet me

pavarësinë e Byrosë është mënyra e zgjedhjes së drejtorit të saj dhe anëtarëve të komisionit mbikëqyrës, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Sipas draftit aktual, drejtori dhe këta anëtarë do të zgjidhen me shumicë të thjeshtë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, pra me gjysmën e deputetëve që janë të pranishëm dhe votojnë. Në

këtë kontekst, Instituti i Kosovës për Drejtësi rekomandon që kjo shumicë të rritet, në mënyrë që të garantohet gjithëpërfshirje më e madhe dhe pavarësi më e madhe, në mënyrë që Byroja të mos konceptohet si instrument i qeverisë. Nëse kërkohet vetëm shumicë e thjeshtë, atëherë drejtori dhe anëtarët e komisionit mbikëqyrës mund të zgjidhen lehtësisht nga partia në pushtet, e cila zakonisht e ka shumicën e nevojshme në Kuvend. Për këtë arsye, Instituti i Kosovës për Drejtësi rekomandon që të kërkojnë të paktën 61 vota për zgjedhjen e drejtorit të Byrosë dhe anëtarëve të komisionit mbikëqyrës, të cilët zgjidhen nga Kuvendi", është shprehur Shala.

Sipas tij, projektligji ka shënuar përparime edhe në përcaktimin e periudhës së verifikimit, për të cilën Gjykata Kushtetuese më herët kishte evidentuar problematika.

PUNËTORËT E RTK-së PA PAGA PREJ 10 DITËSH, SINDIKATAT PARALAJMËROJNË PROTESTË TË HËNËN

PRISHTINË, 10 KORRIK - Sindikata e Punëtorëve të Radio Televizionit të Kosovës (SPERTK) dhe Federata Sindikale e RTK-së kanë paralajmëruar protesta, duke bërë me dije se kanë përfunduar të gjitha mundësitë për pritje lidhur me ekzekutimin e pagave të punonjësve. Sipas reagimit të dy organizatave sindikale, të premtën janë bërë dhjetë ditë që punëtorët e transmetuesit publik kanë mbetur pa paga të rregullta. "Pas takimit urgjent të zhvilluar me u.d. drejtorin e përgjithshëm të RTK-së, u kërkua alokimi i menjëhershëm i mjeteve. Sindikatat vendosin këtë ultimatum të prerë: Nëse pagat nuk alokohen në llogaritë e punëtorëve gjatë



ditës së sotme, nga dita e hënë do të fillojmë me protesta. Të hënë, më 13 korrik 2026, në orën 11:30, ftojmë të gjithë punëtorët pa dallim që të bashkohen në protestë para objektit të RTK-së - TV. Duhet ta bëjmë të qartë se paga nuk

është privilegj, por është një e drejtë elementare dhe ligjore që po u mohohet punëtorëve të RTK-së", është thënë në reagim Federata Sindikale e RTK-së dhe SPERTK kanë kritikuar bordin dhe menaxhmentin e

RTK-së, duke i akuzuar për dështim në menaxhimin e situatës dhe për përsëritje të krizave me pagat e punëtorëve. "Nuk ka më hapësirë për premtime apo arsyetime burokratike që rrezikojnë mirëqenien e qindra familjeve. Përveç bllokimit të procesit të punës, Federata Sindikale e RTK-së dhe SPERTK, nga e hëna, do të kërkojnë llogaridhënie të plotë ligjore dhe morale. Këto dy organe të RTK-së po e paraqesin situatën si normale, ndonëse ajo aspak nuk është e tillë. Kjo papërgjegjshmëri po përsëritet, ndonëse ligji i obligon edhe bordin, edhe menaxhmentin që të sigurojnë funksionim normal të RTK-së. Bordi dhe menaxhmenti kanë treguar

dështim total, paaftësi operative dhe shkelje të drejtave elementare. Rikujtojmë se ky nuk është lëshimi i tyre i parë; të njëjtit, bordi dhe menaxhmenti, janë përgjegjës që i lanë punëtorët pa paga edhe gjatë muajve të kaluar. Përsëritja e këtyre krizave tregon qartë se këta zyrtarë janë tërësisht të paafët për ta ushtruar këtë veprimtari dhe për të udhëhequr transmetuesin publik. Gjendja ekonomike e kolegëve tanë nuk pret më. Ftojme të gjithë punëtorët e RTK-së që të qëndrojnë të bashkuar dhe të gatshëm për të mbrojtur dinjitetin dhe djersën tonë", është thënë në reagimin e Federatës Sindikale të RTK-së dhe SPERTK-së.

Oficerë të FSK-së diplomojnë në Shqipëri, trajnohen për drejtimin e operacioneve ushtarake

TIRANË, 10 KORRIK - Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, oficerë të Forcës së Sigurisë së Kosovës kanë diplomuar me sukses në Kursin e Lartë të Oficerit dhe në Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm. Sipas njoftimit të FSK-së, këto programe të avancuara të edukimit ushtarak kanë për qëllim zhvillimin e njohurive dhe aftësive profesionale për

planifikimin, organizimin dhe drejtimin e operacioneve ushtarake në mjedise komplekse të sigurisë. FSK-ja ka bërë me dije se këto programe përgatitin oficerët për të marrë vendime të bazuara në vlerësime profesionale, si dhe për të ofruar këshillim ushtarak në proceset e planifikimit dhe përdorimit të forcës. "Përfundimi me sukses i këtyre kurseve përfaqëson një arritje të rëndësishme në

zhvillimin profesional të oficerëve të FSK-së, duke kontribuar në ngritjen e kapaciteteve udhëheqëse dhe operacionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjithashtu, dëshmon bashkëpunimin e ngushtë dhe të qëndrueshëm ndërmjet institucioneve ushtarake të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë në fushën e edukimit dhe aftësimit ushtarak", ka njoftuar FSK-ja.



HODGES: NGËRÇI POLITIK E BËN KOSOVËN MË TË CENUESHME NDAJ NDIKIMEVE TË JASHTME

PRISHTINË, 10 KORRIK - Ish-gjenerali amerikan që kishte drejtuar Komandën amerikane në Evropë, Ben Hodges, në një intervistë për "Radio Evropa e Lirë" ka folur për Samitin e NATO-s që është mbajtur në Ankara dhe për atë se ku gjendet Kosova e rajoni i Ballkanit Perëndimor në agjendën e Aleancës Veri-Atlantike. Hodges ka thënë se është i bindur që NATO do të vazhdojë të punojë edhe me shtete të vogla si Kosova për të gjetur mënyra për integrim më të mirë. Ai ka thënë se s'është e pëlqyeshme që gjithçka të mbështetet në kapacitetet e ShBA-së. "Nuk është e dëshirueshme që gjithçka të mbështetet vetëm në kapacitetet e Shteteve të Bashkuara. Pikërisht për këtë ka paralajmëruar prej kohësh presidenti (i Francës, Emmanuel) Macron, duke theksuar rrezikun e mbështetjes së tepërt të ShBA-ja. Sepse, nëse krijohet një situatë ku administrata amerikane nuk perceptohet si plotësisht e besueshme, ose nëse çdo gjë trajtohet vetëm si një transaksion, atëherë pjesa tjetër e Aleancës bëhet më e cenueshme", ka thënë Hodges. Sa i përket mospërmendjes së rajonit në deklaraten përmblyëse të samitit të mbajtur

në Ankara, Hodges ka thënë se situata është sfiduese në shumë dimensione dhe se nuk e di ku saktësisht është Ballkani Perëndimor në listën e prioritetëve të Aleancës. Ai nuk i ka dhënë ndonjë rëndësi mospërmendjes së rajonit në Samit, duke thënë se ai i radhës që do të mbahet në Tiranë është mundësi e mirë për rikthimin e rajonit në agjendë. "Megjithatë, nuk do t'i jepja ndonjë kuptim të veçantë faktit që Ballkani Perëndimor nuk u përmend në deklaratën e publikuar pas samitit. Në fund të fundit, samiti përbëhej nga një darkë, një takim i përbashkët dhe disa bisedime dypalëshe që u zhvilluan paralelisht. Samitin e ardhshëm pritet ta organizojë Shqipëria. Tani ekziston një ide që vitin e ardhshëm të mos mbahet, kështu që, nëse kjo ndodh, Shqipëria do të ishte mikpritëse në vitin 2028. Kjo do të ishte një mundësi për ta kthyer vëmendjen të Ballkani, ashtu siç organizimi i samitit nga Turqia ndihmoi që fokusi të vihej te Deti i Zi dhe te roli i Turqisë", ka thënë Hodges. Duke folur për krizën politike në Kosovë dhe për ndikimin që kjo situatë mund të ketë në aspektin e sigurisë, Hodges ka thënë se si pasojë e zhvillimeve të tilla Kosova mbetet e cenueshme ndaj ndikimeve të jashtme.



Ish-gjenerali amerikan ka thënë se Rusia s'ka asnjë interes që Kosova të bëhet shtet i konsoliduar dhe për aq kohë sa Kosova mbetet në vendnumërim, do të jetë e ekspozuar ndaj shteteve që duan destabilizim. "Natyrshisht, një situatë e tillë e mban Kosovën të cenueshme ndaj ndikimeve të jashtme. Rusia nuk ka asnjë interes që Kosova të bëhet një shtet i fortë, liberal-demokratik, i integruar në Bashkimin Evropian, në NATO apo në struktura të ngjashme. Prandaj, për sa kohë që Kosova nuk arrin ta zgjidhë këtë situatë, ajo do të mbetet e pambrojtur ndaj atyre që synojnë ta ruajnë status quo-në dhe të vazhdojnë ta

destabilizojnë vendin", ka thënë Hodges. Sa i përket misionit të KFOR-it në Kosovë dhe nëse mund të pritet ndonjë ndryshim në të, Hodges ka thënë se shpreson që KFOR-i të vazhdojë të qëndrojë në Kosovë. "Nuk e di. Unë shpresoj që misioni i KFOR-it të vazhdojë. Mendoj se ta kam përmendur edhe në një bisedë të mëparshme që kemi pasur: njëherë, një zyrtar i lartë i Kosovës dhe një zyrtar i lartë i Serbisë më thanë të njëjtën gjë: 'Ju lutem, mos e tërhiqni KFOR-in, sepse ai është e vetnja spirancë e stabilitetit'", ka treguar Hodges. "Kjo ka ndodhur disa vite më parë, por ajo bisedë më ka

mbetur në mendje. Tregon se nuk është e nevojshme të ketë një numër të madh trupash në terren; vetë prania e KFOR-it shërben si një pikë stabiliteti", ka thënë Hodges. Duke folur për rëndësinë e pranisë amerikane në Kosovë, Hodges ka thënë se është e rëndësishme meqë është edhe enë interes të ShBA-së që Evropa të jetë e sigurt. "Vetëm kështu ajo mund të jetë edhe e begatë, pasi Evropa është partneri më i madh tregtar i Amerikës. Prandaj, paqëndrueshmëria në Ballkanin Perëndimor kontribuon në paqëndrueshmërinë edhe në pjesë të tjera të Evropës dhe krijon dobësi që Rusia do të përpiqet t'i shfrytëzojë. Kështu do ta formuloja unë rëndësinë e pranisë amerikane në Kosovë", ka shtuar ish-ushtaraku amerikan. Në fund, Hodges duke folur për atë se çfarë mund të bëjë Kosova për t'u bërë një partnerë e besueshme, ka thënë se Prishtina zyrtare duhet të vazhdojë të punojë për përmbushjen e kushteve që kërkohen për anëtarësim në Bashkimin Evropian. "Ky është drejtimi ku duhet të ecë. Mendoj se kjo do ta plotësonte edhe synimin për ta bërë Kosovën një partnerë më të vlefshme për NATO-n, nëse kjo është në interesin e saj", ka potencuar Hodges.

Haxhiu dekoron me medalje presidenciale ushtarake kolonelin amerikan A. J. Berg



Prishtinë, 10 korrik - Ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, e ka dekoruar me Medaljen presidenciale ushtarake, kolonelin A. J. Berg. Kjo është bërë në shenjë vlerësimi për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në forcimin e partneritetit strategjik dhe bashkëpunimit ushtarak ndërmjet Republikës së Kosovës

dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. "Pata kënaqësinë ta dekoroj me Medaljen presidenciale ushtarake kolonelin A. J. Berg, në shenjë vlerësimi për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në forcimin e partneritetit strategjik dhe bashkëpunimit ushtarak ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të

Amerikës. Në përfundim të mandatit të tij si atashe i mbrojtjes i ShBA-së në Kosovë, e falënderova për angazhimin e tij të palëkundur në mbështetjen e zhvillimit dhe modernizimit të FSK-së, avancimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe thellimin e marrëdhënieve në fushën e mbrojtjes mes dy vendeve tona", ka njoftuar Haxhiu.

Kushtetuta parasheh që presidenti duhet të zgjidhet brenda 60 ditëve nga dita e konstituimit të Kuvendit. Nëse kjo nuk ndodh, Kuvendi shpërndahet dhe vendi shkon në zgjedhje të reja. Nëse vendi shkon sërish në zgjedhje, atëherë ato do të ishin të katërtat parlamentare që nga shkurti i vitit 2025.

Uk Lushi, Kurtit: Propozojë Hashim Thaçin për president, zgjidhet problemi

Veprimtari shqiptar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Uk Lushi, ka reaguar ndaj deklaratës së kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, lidhur me

përgjegjësinë për zgjedhjen e presidentit të vendit. Duke cituar deklaratën e Kurtit se "për qeverisje përgjegjësi është te ne. Për presidentin përgjegjësi është e të gjithëve", Lushi e ka akuzuar atë për manipulim dhe ka thënë se nuk mund të ketë përgjegjësi pa të drejta. Në reagimin e tij, Lushi i ka bërë thirrje Kurtit që ta propozojë Hashim Thaçin për president të Kosovës, duke pretenduar se në këtë mënyrë do të zgjidhej problemi. "Sa bukur dhe manipulueshëm flet qerratai! Nuk ka, Albin, përgjegjësi pa të drejta. Propozojë Hashim Thaçin president dhe kryhet problemi. Fiton më së shumti ti, Albin, mandej kombi, Thaçi, ndërsa humbësit e vetëm dalin qenefat e huaj! A guxon, Albin?", ka shkruar Lushi në rrjetet sociale.



A KA KOSOVA RREGULLA TË QARTA PËR PRODUKTET E QUMËSHTIT?

PRISHTINË, 10 KORRIK - Në javët e fundit në Kosovë është hapur një debat mbi rregullat dhe kontrollat për përbërjen dhe cilësinë e produkteve të qumështit, duke nxitur përplasje mes institucioneve dhe prodhuesve. Edhe pse Kosova e ka Ligjin për Ushqimin, aktualisht nuk ka një rregullore të posaçme që rregullon etiketimin, prezantimin dhe reklamimin e produkteve ushqimore, përkatësisht atyre të qumështit. Një akt i tillë nënligjor do të përcaktonte më qartë kriteret për emërtimin dhe përbërjen e produkteve të qumështit, si dhe mënyrën se si ato prezantohen para konsumatorëve në tregun vendor.

Rregullorja e mëparshme, e nxjerrë në vitin 2013, u shfuqizua në vitin 2021, së bashku me një sërë aktesh të tjera nënligjore. Që prej atëherë, disa aspekte të kësaj fushe mbështeten në dispozitat e përgjithshme të legjislacionit për ushqimin dhe në akte të tjera përkatëse, ndërsa rregullat specifike për produktet e qumështit mbeten të papërcaktuara në një dokument të vetëm.

Çfarë rregullash ka Kosova?

Kosova e ka Ligjin për Ushqimin, i cili kërkon që produktet ushqimore të jenë të sigurta dhe të etiketohen qartë. Kompanitë rrezikojnë gjoba deri në 20 mijë euro nëse konstatohet se kanë kryer shkelje. Megjithatë, që nga viti 2021 nuk ka një rregullore të veçantë

që përcakton se kur një produkt mund të quhet "qumësht", "djathë" apo "gjalpë", dhe si duhet të deklarohet përbërja e tij. Muhamet Kamberi, ligjërues i legjislacionit dhe menaxhimit të cilësisë së ushqimeve në Fakultetin e Bujqësisë në Prishtinë, ka deklaruar për "Radion Evropa e Lirë" se një rregullore e re do t'i përcaktonte hollësitë teknike që ligji nuk i specifikon. "Përmbajtja e rregullores apo udhëzimit administrativ e tejkalon shumëfish përmbajtjen e ligjit, sepse ligji është i bazuar në Kushtetutë dhe është për t'i vendosur shtyllat themelore se si duhet të rregullohet një çështje. Hollësitë specifike definojnë nga rregullorja", është shprehur ai.

Çështjet që lidhen me sigurinë e ushqimit dhe etiketimin e produkteve ushqimore rregullohen kryesisht nga Ministria e Bujqësisë, në bashkëpunim me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), ndërsa aspektet e mbrojtjes së konsumatorit mbeten në përgjegjësinë e Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë.

Ministria e Bujqësisë nuk u është përgjigjur pyetjeve të "REL"-it nëse po punon për hartimin e një rregulloreje të re.

Në mungesë të një rregulloreje, autoritetet kanë përdorur Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit për të kryer kontrole dhe inspektime, si dhe për t'u bërë thirrje kompanive që ta paraqesin qartë përbërjen dhe përmbajtjen e produkteve. Një thirrje të tillë e bëri



A përcakton ligji kufi në përdorimin e vajit të palmës?

Nuk ka ndonjë ligj apo rregullore që përcakton se në çfarë mase apo sasi mund të përdoret vaji i palmës në produktet ushqimore, qoftë ato të qumështit apo të tjera. Legjislacioni në fuqi kërkon vetëm që produktet të etiketohen saktë dhe të mos e mashtrojnë konsumatorin. Debatet për këtë çështje u intensifikua pasi inspektorët e AUV-it, më 2 korrik, kryen kontrole në fabrikën "Vita" në Istog, ku morën mostra të qumështit me afat të gjatë përdorimi, qumështit pluhur dhe vajit të palmës për analiza laboratorike. Pas kontroleve, ministri në detyrë i Bujqësisë, Armend Muja, ka deklaruar se një raport fillestar i AUV-it tregon se kompania "prodhon produkte shtazore të përziera me vaj palme" dhe se analizat laboratorike do ta konfirmojnë këtë.

"Pa asnjë fije dyshimi, qumështorja 'Vita' prodhon qumësht të përzier me vaj

palme dhe të gjitha... Nuk i ka produktet 100 për qind qumësht", është shprehur Muja në emisionin "Pressing" në "T7".

Teksa priten rezultatet përfundimtare, kompania ka pezulluar përkohësisht punën.

Si krahasohet Kosova me BE-në?

Ndryshe nga Kosova, Bashkimi Evropian ka legjislacion për ushqimin që përcakton në mënyrë të detajuar se si duhet të mbrohen dhe kontrollohen produktet e qumështit. Ky legjislacion përcakton se produkt qumështi është çdo produkt që rrjedh ekskluzivisht nga qumështi dhe se mund të shtohen substanca të nevojshme për prodhim vetëm me kusht që ato të mos përdoren për të zëvendësuar, tërësisht ose pjesërisht, ndonjë përbërës të qumështit.

Rregullorja e BE-së e vitit 2013 përcakton se çfarë quhet qumësht dhe i mbron emërtimet e produkteve të qumështit me origjinë të pastër shtazore, si qumështi, ajka, gjalpë dhe djathi. Në përgjithësi, produktet me bazë bimore nuk mund t'i përdorin këto emërtime. Rregullorja përcakton gjithashtu se të gjithë përbërësit duhet të deklarohen në etiketë, të renditen sipas peshës, nga ai me përmbajtjen më të madhe te ai me më të voglën, si dhe të identifikohen me emrin e tyre specifik.

Kamberi ka vlerësuar se Kosova e ka tejzgatur procesin e përafritimit të legjislacionit të saj me atë të Bashkimit Evropian.

ASK-ja: INFLACIONI VJETOR NË KOSOVË ARRIN NË 6 PËR QIND, TRANSPORTI DHE ENERGJIA ME RRRITJEN MË TË MADHE

Prishtinë, 10 korrik - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin qershor 2026, sipas të cilit inflacioni vjetor ka arritur në 6.0 për qind, ndërsa në baza mujore është regjistruar një rënie prej 0.1 për qind. Sipas ASK-së, rritja vjetore e çmimeve është ndikuar kryesisht nga shtrenjtimi i transportit me 13.7 për qind, strehimit, furnizimit me ujë, energjisë elektrike, gazit dhe lëndëve të tjera djegëse me 11.1 për qind, pijeve alkoolike, duhanit dhe narkotikëve me 5.1 për qind, restoranteve dhe shërbimeve të akomodimit me 4.5 për qind, si dhe

shëndetësisë me 4.1 për qind. Rritje të çmimeve janë regjistruar edhe te ushqimet dhe pijet joalkoolike me 3.9 për qind, kujdesi personal dhe shërbimet e ndryshme me 3.2 për qind, mobiljet, pajisjet shtëpiake dhe mirëmbajtja rutinore e banesës me 3.0 për qind, veshjet dhe këpucët me 2.3 për qind, rekreacioni, sporti dhe kultura me 2.0 për qind, si dhe informacioni dhe komunikimi me 0.2 për qind.

Në anën tjetër, ulje vjetore e çmimeve është regjistruar vetëm te shërbimet arsimore, me 0.6 për qind.

Krahasuar me muajin maj, indeksi i çmimeve të konsumit ka shënuar një rënie mesatare



prej 0.1 për qind. Kjo është ndikuar kryesisht nga ulja e çmimeve të ushqimeve dhe pijeve joalkoolike me 0.6 për qind, si dhe e strehimit,

furnizimit me ujë, energjisë elektrike, gazit dhe lëndëve djegëse me 0.3 për qind. Ndërkohë, në baza mujore janë regjistruar rritje të çmimeve në

rekreacion, sport dhe kulturë (0.8 për qind), shërbimet arsimore (0.5 për qind), kujdesin personal dhe shërbimet e ndryshme (0.4 për qind), transport (0.3 për qind), pijet alkoolike, duhanin dhe narkotikët (0.2 për qind), mobiljet, pajisjet shtëpiake dhe mirëmbajtjen rutinore të banesës (0.2 për qind), restorantet dhe shërbimet e akomodimit (0.2 për qind), veshjet dhe këpucët (0.1 për qind), si dhe shëndetësinë (0.1 për qind).

ASK-ja ka njoftuar se publikimi është realizuar duke zbatuar klasifikimin e ri COICOP 2018, me vit bazë 2025 = 100 dhe metodologji të përditësuar.

URREJTJA NDAJ UÇK-së NGA PJELLA JUGOSLLAVE DHE SERBE!



Behxhet Sh. SHALA – BAJGORA

